	PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS		F-009-54
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 1 nga 2

Përshkrimi i vendit të punës

Data e hyrjes në fuqi: 01.09.2023

Pozita:

Zyrtar për Prokurim dhe Kontabilitet



Përmbledhje

Zyrtari për Prokurim dhe Kontabilitet kryen detyra nga fusha e prokurimit dhe financave, në përputhje me politikat, udhëzuesit dhe procedurat e KEC.

Kualifikimet

- Përgatitje superiore ose përvojë pesëvjeçare relevante e punës;
- Aftësi të dëshmuara për procedurat e prokurimit dhe financiare - preferohet përvojë 2-vjeçare e punës në pozitë të ngjashme;
- Njohuri të avancuara të kuptuarit dhe shkruarit të gjuhës shqipe dhe njohuri solide e gjuhës angleze;
- Njohuri të avancuara në përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe pakove softuerike përkatëse, me qëllim të organizimit të punës.


Aftësitë tjera

- Aftësi të mira analitike dhe të punës me të dhëna sasiore dhe cilësore;
- Aftësi shumë të mira të komunikimit;
- Aftësi për të punuar nën stres dhe për të ofruar zgjidhje në situata të vështira;

Detyrat

Prokurimi

- Udhëheqë dhe mbikëqyrë procedurat për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve në përputhje me udhëzuesit përkatës;
- Pranon dhe procedon kërkesat e miratuara për blerje, sipas procedurave të prokurimit;
- Menaxhon kontratat dhe marrëveshjet me furnitorët, duke përfshirë rishikimin e kushteve, negocimin e çmimit dhe kushtet e pranim/dorëzimit të mallrave dhe shërbimeve;
- Në konsultim me menaxherët e projekteve të KEC, harton dhe mbikëqyr zbatimin e Planit vjetor të prokurimit;

	PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS		F-009-54
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 2 nga 2

- Këshillon menaxhmentin dhe personelin e KEC dhe Shkollës “Mileniumi i Tretë” për procedurat e prokurimit;
- Sipas nevojës, ndërmerr nisma për ndryshime dhe plotësime të procedurave të prokurimit;

Financat

- Monitoron dhe administron arkën, duke përfshirë depozitimin e parave në bankë.
- Nën mbikëqyrjen e udhëheqësit përgjegjës të administratës dhe financave përfshihet në kryerjen e procedurave të kontabilitetit financiar, raportimeve financiare dhe auditimit;

Të tjera

- Kryen punët të tjera në pajtim me kualifikimin e vet dhe udhëzimet e mbikëqyrësit

Lidhjet dhe raportimet

Zyrtari për Prokurim dhe Kontabilitet i raporton Udhëheqësit të Administratës dhe Financave të KEC dhe Udhëheqësit të Administratës dhe Financave të Shkollës “Mileniumi i Tretë”

Orët e punës

Zyrtari për Prokurim dhe Kontabilitet ka orar të plotë të punës prej 8 orëve në zyrën e administratës duke u nënshtruar edhe orëve shtesë varësisht prej nevojës dhe kërkesave specifike nga mbikëqyrësit

Kompensimi

Kompensimi i Zyrtarit për Prokurim dhe Kontabilitet bëhet konform kontratës së punës dhe mund të ndryshohet apo të modifikohet varësisht prej rezultateve të vlerësimit të performancës dhe udhëzimeve nga drejtori.

Versioni	Përshkrimi i ndryshimit	Data
1.0	Publikimi fillestar	01.09.2023